

URDHËR
Nr. 14, datë 1.11.2017

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, z. Plarent Ndreca, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, për prokurimet e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe udhë-zimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, të dala në bazë dhe për zbatim të procedurave përkatëse.
2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31.12.2017.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, z. Plarent Ndreca.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi